

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetar i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve B. K. dhe A. G., për shkak të veprës penale Marrja e rryshfetit, të parashikuar nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.151/16 të dt.21.11.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezentuar prokurorja e shtetit Fikrije Fejzullahu, i akuzuari B. K. dhe mbrojtësi i tij me autorizim zëvendësues av. B. Sh., i akuzuari A. G. dhe mbrojtësi i tij av.B. E., sipas autorizimit, me dt.27.03.2017, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit :

B. K., i biri i R. dhe S., e gjinisë I., i lindur me dt.*data e lindjes...*, në fshatin B., komuna e V., tani me vendbanim në P., lagj.”...”, banesat e t., hyrja ., banesa nr., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, zyrtar policor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, dhe

A. G., i biri i R. dhe S., e gjinisë K., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në P., tani me vendbanim në F.-K., rr.”...”, Kompleksi i banesave, “...”, kati ., ku edhe jeton, rr.’...’, pn., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Sepse:

Me dt.06.10.2016 derisa ishin në kryerjen e detyrës zyrtare në cilësi të personave zyrtarë si polic të sektorit të patrullës, pas marrëveshjes paraprake me njëri-tjetrin e duke e shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtarë, kanë kërkuar nga dëshmitari Q. I. një shumë parash me kusht që të njëjtë t’ia fshehin 11 (njëmbëdhjetë) qese me narkotik të llojit “Marihuanë”, nga 13 (trembëdhjetë) qese që i ishin gjetur paraprakisht nga pjesëtarët e policisë, duke e kërcënuar se në të kundërtën pasojat e këtij veprimi do të ishin të mëdha, ashtu që i dëmtuari me qëllim që të shpëtoj më lehtë, përfshirë edhe mos caktimin e paraburgimit, e pranon kërkesën e tyre dhe të njëjtëve ua jep 100 (njëqind) euro, me ç’rast të pandehurit e lirojnë të dëmtuarin, e që i dëmtuari të nesërmen rastin e paraqet në polici.

-me këtë kanë kryer veprën penale Marrja e rryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 45, 46, 47, 69, 73, 74, 76, dhe 428 të KPRK-së, si dhe nenet 359, 365, 366, 367, 368, 450 dhe 453 të KPPRK-ës, i:

GJYKON

Të akuzuarin B. K. me :

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.07.10.2016 e deri me dt.29.11.2016, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë, duke ia llogaritur një ditë me burgim, me 20 (njëzetë) euro gjobë, konform nenit 47 të KPRK-së, dhe

DËNIM ME GJOBË në shumën prej 400 (katërqind) euro, të cilën gjobë është i detyruar ta paguaj brenda afatit ligjor prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarin A. G. me :

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.07.10.2016, e deri më datën 29.11.2016, me pëlqimin e të akuzuarit, dënimi me burgim i zëvendësohet me dënim me gjobë, duke ia llogaritur një ditë me burgim, me 20 (njëzetë) euro të dënimit me gjobë, konform nenit 47 të KPRK-së, dhe

DËNIM ME GJOBË në shumën prej 400 (katërqind) euro, të cilën gjobë është i detyruar t'a paguaj brenda afatit ligjor prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund t'a paguajnë dënimin me gjobë, Gjykata ua zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ua llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të dënimit me gjobë.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërkaq në emër të paushallit gjyqësor, secili veç e veç shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të cilën shumë duhet t'a paguajnë në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konfiskohen një bankënotë në vlerë prej 50 € euro, me nr. serik X73509151556, një bankënotë prej 20 € euro me nr.serik SA8221134227, dhe një bankënotë prej 10 € eurove, me nr.serik PA3594431159, si dhe konfiskohen 13 (trembëdhjetë) qese të vogla me marihuanë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë, PP/L.nr.151/16 të dt.21.11.2016 kundër të akuzuarve B. K. dhe A. G., për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar mirë, se të njëjtit e kanë kryer veprën penale si në hyrje të aktgjykimit.

Sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.31/17 të dt.21.02.2017, sipas të cilit aktvendim çështja është kthyer në rigjykim, me ç'rast gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.27.03.2017, ku gjatë kësaj seance, të akuzuarit në prezencën e mbrojtësve të tyre, e kanë pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale me të cilën janë akuzuar

Meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht dhe pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësit, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarve për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetoi se në veprimet e të akuzuarve B. K. dhe A. G., manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Marrja e ryshfetit nga neni 428 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ashtu që të akuzuarit edhe i shpalli fajtorë, dhe ua shqiptoj sanksionet penale përkatëse, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit lidhur me rrethanat për shqiptimin e sanksionit penal, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës së dhënë në shqyrtimin fillestar të parë të dt. 29.11.2016, ne te cilien ka deklaruar se meqë të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që të njëjtit ti shpall fajtorë dhe t'ua shqiptoj sanksionet penale përkatëse, duke i vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e sanksionit penal.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. K. sipas autorizimit zëvendësues av.B. Sh., ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës së dhënë në shqyrtimin e parë nga kolegu i tij, av. M. H., i cili ndër të tjera ka shtuar se kërkoj nga gjykata që t'i shqyrtoj pretendimet ankimore të mbrojtjes të precizuara në ankesë kundër aktgjykimit në gjykimin e parë. Ndërsa në gjykimin e parë, i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë lehtësuese ta marrë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit B. K., se i njëjti është penduar dhe ka shpreh keqardhje të thellë për këtë veprë, deri në këtë rast ka marrë disa herë lëvdata për punën të cilën e ka kryer, asnjëherë më parë nuk ka qenë i gjykuar, i njëjti është baba i tre fëmijëve të rritur, është i gjendjes së rëndë ekonomike, mbajtës i vetëm i familjes, si dhe t'a vlerësoj edhe qëndrimin e të mbrojturit të tij në paraburgim i cili qëndrim pothuajse e ka arritur edhe qëllimin e përgjithshëm të sanksionit penal, dhe në fund i propozon gjykatës që mundësisht t'i shqiptohet një dënim i kushtëzuar, në rastin më të pafavorshëm, t'i shqiptohet një dënim i cili do të kishte mundësi të shndërrohej në dënim me gjobë.

I akuzuari B. K. e ka mbështetë në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij lidhur me rrethanat për shqiptimin e dënimit, dhe i njëjti ka shpreh keqardhje dhe pendim të thellë për këto veprime, duke shtuar se kjo ka ndodhë për herë të parë në jetën e tij, dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen asnjëherë nuk do ti përsëris veprime të tilla të ngjashme.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. G., av.B. E., ka deklaruar se mbetet pranë të thënave në gjykimin e kaluar, fillimisht i ka propozuar gjykatës që si rrethanë veçanërisht lehtësuese t'a vlerësoj pranimin e fajësisë, ndërkaq si rrethana lehtësuese t'i vlerësoj faktet se i njëjti është i gjendjes së rëndë ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes, i pa punë, asnjëherë më parë nuk ka qenë i gjykuar, pasojat e shkaktuara nga kjo veprë penale, duke i propozuar gjykatës që të njëjtit t'i shqiptohet një dënim sa më i butë i mundshëm, kjo për faktin se edhe me një dënim të butë do të arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksionit penal konform nenit 41 të KPRK-së.

I akuzuari A. G. e ka mbështetë në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij, dhe ka shtuar se tani më është i vetëdijësuar për veprimet e tij të kundërligjshme, thellësisht është penduar dhe se i vie turp nga vetvetja për atë që ka bërë, dhe i premtun gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, se i njëjti jeton në një gjendje të rëndë ekonomike, duke e lutur në fund kryetarin e trupit gjykues, që të njëjtit t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarit, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, si rrethanë veçanërisht lehtësuese për të dy të akuzuarit vlerësoi faktin se të njëjtit të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sqartë dhe me vetëdije të plotë, konform nenit 76 par.1 nënpar.1.5 të KPRK-së, ndërkaq si rrethana lehtësuese vlerësoi faktin se të dy të akuzuarit kanë shpreh keqardhje për këto veprime, janë penduar thellë dhe i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do ti përsërisin asnjëherë këto veprime të kundërligjshme, se të njëjtit nuk kanë qenë më parë të gjykuar, kjo ka qenë hera e parë që kanë ra ndesh me

ligjin, janë të gjendjes së rëndë ekonomike, se janë mbajtës të vetëm të familjes, e në mungesë të rrethanave rënduese, gjykata të akuzuarve ua shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se ky sanksion penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarve, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarve dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata me pëlqimin e të akuzuarve, dënimin e shqiptuar me burgim pas shpalljes së aktgjykimit, ua zëvendëson në dënim me gjobë duke ua llogaritur për çdo ditë burgim nga 20 (njëzetë) euro të dënimit me gjobë. Gjykata me rastin e zbatimit të këtij neni vlerësoi edhe udhëzimet e Gjykatës së Apelit, mirëpo në rastin konkret kjo gjykatë vlerëson se për këtë veprë penale, gjykata nuk ka kompetencë që ti shqiptoj fare dënim me gjobë, por vetëm i jep mundësinë të akuzuarve, që me pëlqimin e tyre mund t'iu zëvendësohet dënimi i shqiptuar me burgim në dënim me gjobë. Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret, është e detyruar ta respektoj llogaritjen e një dite burgim me 20 euro të gjobës, për faktin se të akuzuarit kanë qëndruar nën masën e paraburgimit rreth 51 ditë, dhe në rast se të akuzuarit pajtohen me zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë, tani në dënimin me gjobë do t'iu llogariten ditët e kaluara në paraburgim dhe atë për çdo ditë paraburgim 20 euro të gjobës, dhe nëse është kështu atëherë kjo gjykatë nuk mund të i shqiptoj dënim me gjobë, jashtë asaj si është e llogaritur me dispozita ligjore të detyrueshme për një ditë burgim 20 euro të dënimit me gjobë.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarve, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e tri bankënotave në vlerë prej 50, 20 dhe 10 € euro, dhe 13 (trembëdhjetë) qeseve të vogla me marihuanë, është marrë konform nenit 69 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.77/17, dt.27.03.2017

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.